

**Zhvillimi Institucional i Ekonomisë së Tregut në Shqipëri:
Disa Vrojtime bazuar në Eksperiencën e
Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare**

**Komente nga
J. Andrew Spindler
Drejtor Ekzekutiv
Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare
Konferenca e IV e Bankës së Shqipërisë me Temë
“Ekonomia Shqiptare: Arritjet dhe Sfidat e Politikës Ekonomike”**

Sarandë, Shqipëri
e Enjte, 11 Shtator, 2003

Në fillim të fjalës sime, do të dëshiroja të vija në dukje se jemi takuar këtu në përvjetorin e dytë të sulmeve terroriste ndaj Qendrës Tregtare Botërore dhe Pentagonit. Tema jonë në këtë Konferencë, ecuria e ekonomisë shqiptare, mund të duket mjaft larg prej atyre momenteve të tmerrshme dhe të trishtueshme dhe prej jehonës së tyre. Por, forcimi i ekonomive të tregjeve në zhvillim mund të ndihmojë kudo për reduktimin e varfërisë, për përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve, si dhe për t’iu drejtuar kushteve të gjendjes pa rrugëdalje dhe dëshpërimit, të cilat mund të shërbejnë si ushqim për ideologjitë terroriste. Forcat e kapitalizmit të tregut dhe globalizimit kanë përmirësuar mirëqënien materiale të qindra miliona njerëzve, por shumica e popujve të botës nuk kanë përfituar në mënyrë të ndjeshme. Duke punuar së bashku, duhet të gjejmë një mënyrë për ta ndryshuar këtë gjë.

Është nder dhe kënaqësi për mua që ndodhem këtu sot për të folur rreth zhvillimit institucional të ekonomisë së tregut në Shqipëri. Në prezantimin tim do të përqëndrohem në infrastrukturën e tregut financiar. Por, para se të marr në konsideratë pjesë të infrastrukturës financiare që janë më të rëndësishme për mbështetjen e ekonomisë së

tregut, do të doja të bëja një hap prapa dhe të trajtoja më gjerësisht një pyetje themelore, përgjigjen e të cilës shumë prej nesh e marrin si të mirëqënë. Shprehimisht, pse duhet që Shqipëria ose ndonjë vend tjetër në tranzicion të përpiqet të zhvillojë një ekonomi tregu? Besoj se kjo gjë është e detyrueshme, por gjithashtu, ajo shoqërohet edhe me rreziqe në rrugën e saj. Do të dëshiroja t'i kushtoja vëmendje disave prej këtyre rreziqeve dhe hapave, që Shqipëria dhe vende në pozicione të ngjashme me të mund të ndërmarrin për të reduktuar çënueshmërinë e tyre dhe për të maksimizuar përfitimet që mund të marrin nga hyrja në rrugën e tregut.

I. Argument në favor të zhvillimit të një ekonomie tregu

Cili është argumenti në favor të zhvillimit të ekonomisë së tregut? Arsyeja më e fuqishme për të ecur në këtë drejtim, besoj, është potenciali për të përmirësuar standardet e jetesës brenda një vendi, për një pjesë të popullsisë sa më të gjërë të jetë e mundur. Mekanizmi i tregut, ndonëse në asnjë mënyrë i përsosur, ka vërtetuar me kalimin e kohës të jetë shpërndarësi më eficient dhe më i besueshëm i burimeve ekonomike. Ai ofron perspektiva për rritje ekonomike, dhe një nivel jetese më të lartë, gjë që nuk mund të ribëhet nga sisteme ekonomike të planifikuara – shtetërore dhe të drejtuara. Kur punohet siç duhet, ai u ofron konsumatorëve një gamë zgjedhjesh më të gjerë sesa mund të disponoheshin ndryshe. Vendet e orientuara nga tregu kanë, gjithashtu, shansin që të futen në ekonominë e tregut dhe të përfitojnë nga përparime në teknologji, përmirësime kuantike në shpejtësinë e përpunimit të informacionit, dhe nga hyrja në tregje të reja, të cilat karakterizojnë tashmë botën mjaft të ndërruar moderne.

Përfitimet nga një sistem tregu përdoren, gjithashtu, edhe për sektorin financiar. Brenda sferës bankare, mekanizmi i tregut vepron për shpërndarjen e burimeve financiare ndaj huamarrësve më të besueshëm, dhe për ato projekte që ka shumë mundësi të japin kthime më të larta ekonomike. Një sistem bankar i orientuar nga tregu mund të shërbejë si një katalist i fuqishëm për rritje ekonomike, duke e çuar kredinë drejt tentativave më premtuese dhe më frytdhënëse. Një sistem bankar modern dhe i shëndetshëm ofron mbështetje të mëtijshme për rritje ekonomike nëpërmjet efektit të shumëzuesit të parasë me kredi bankare. Në qoftë se sistemi po funksionon siç duhet dhe bankat japin hua bazuar në vendime mbizotëruese (vendime “sa të mban krahu”) për aftësinë e kreditimit, atëherë ai vend duhet të jetë në gjendje të arrijë ndjeshëm ritme më të larta rritjeje, sesa do të ishte e mundur ndryshe.

Por, ka gjithashtu edhe rreziqe. Që një vend si Shqipëria të përdorë një ekonomi tregu të vërtetë, ai duhet të hapë ekonominë e vet dhe kufijtë e veta ndaj një numri forcash të fuqishme. Të paktën në periudhë afatshkurtër, jo të gjitha pasojat mund të jenë pozitive. Në pjesën më të madhe të Evropës Lindore dhe të Rusisë, për shembull, standardet e jetesës vërtet ranë gjatë viteve të para të reformës së tregut, para se të fillonin të rriteshin përsëri. Në eksperiencën e vendeve të tregjeve në zhvillim, në pjesë të tjera të botës, ka evidencë tjetër të mjaftueshme për rreziqet. Në të FSVC-së, kohët e fundit kemi filluar të punojmë në Moroko, ku dobësitë strukturore dhe heqja e proteksioneve të tregut i shtojnë pasiguritë, pasi ky vend po bëhet gjithnjë e më i hapur në ekonominë botërore. Kompanitë e huaja mund të fillojnë të bëhen lojtarë të rëndësishëm në sektorë që dikur ishin sfera e vetme e biznesit lokal. Mund të ndodhin zhvendosje të rëndësishme pune, dhe krijimi në shkallë të gjerë i vendeve të reja të punës do të duhet të jetë prioritet

urgjent. Në mënyrë të paevitueshme, pasi të ndodhë liberalizimi i mëtejshëm në Shqipëri, disa sektorë të ekonomisë shqiptare do të humbasin punën, dhe në një vend tashmë të rënduar nga një normë e lartë papunësie, kjo nuk është një çështje e vogël.

Brenda sektorit bankar, kundërtitë mund të jenë mjaft të forta. Nga njëra anë, një sektor i mbyllur bankar mund të jetë në gjendje të punësojë më shumë njerëz dhe të ruajë një nivel përfitueshmërie, që do të sfidohej ashpërsisht në qoftë se sektori do të ishte më konkurrues dhe/apo në qoftë se institucionet e huaja do të tërhiqeshin nga tregu. Por, një sistem bankar i mbyllur, gjithashtu, mund të bëhet shumë shpejt një sistem i vetëkënaqur, dhe qëllimi për të siguruar kredi dhe shërbime të tjera të rëndësishme bankare cilësore mund të kalojë në çështje dytësore ose të humbasë fare. Sektorë të tërë mund të mos furnizohen. Për shembull, një sektor kritik në një ekonomi, qoftë e përparuar apo në zhvillim, është sektori i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla (SME-të). Shpesh ai është lokomotivë kyç për rritjen ekonomike të një vendi. Në qoftë se konkurrenca në sektorin bankar është e dobët, dhe në qoftë se infrastruktura për raportimin bankar dhe financiar/kontabël nuk është e zhvilluar mirë, eksperiencia sugjeron fuqishëm se sektori i SME-ve nuk do të ketë sukses në marrjen e kredisë së mjaftueshme.

II. Argument për institucione të fuqishme

Do të dëshiroja t'ju argumentoja se institucionet e fuqishme mund të ndihmojnë Shqipërinë të durojë stuhinë e zhvillimit të një ekonomie tregu, dhe, në një kuptim më të gjerë, atë të të hyrjes në ekonominë globale. “Zhvillimi Institucional” mbulon shumë komponentë përbërës, dhe do të doja t'ju jepja një përkufizim lidhur me atë çfarë unë mendoj nëpërmjet kësaj shprehjeje. Në mënyrë specifike, kam në mendje gjithë

infrastrukturën – fizike, ligjore, konceptuale, bazuar në kualifikim, si dhe kulturore – që duhet të jenë në vend, me qëllim funksionimin e një ekonomie tregu. Në themel të kësaj infrastrukture institucionale është një sistem bankar i shëndoshë, i sigurt dhe rregull i ligjit.

Më lejoni të filloj me komponentin bankar. Një sistem bankar i shëndetshëm shërben si sistem qendror nervor i një ekonomie tregu, i cili siguron një vend të sigurt e të besueshëm për kursimet e njerëzve, një burim kritik krediti për të mbështetur aktivitetin sipërmarrës dhe sigurisht edhe rritjen ekonomike, dhe një mjet eficient për transferimin e burimeve financiare për të lehtësuar transaksionet ditore tregtare në ekonominë reale. Një sistem bankar i shëndetshëm nuk ndërtohet brenda një dite, kam parasysh kompleksitetin e komponentëve institucionalë që duhet të jenë të pranishëm për të lejuar një sistem të tillë të veprojë me eficiencë dhe me besueshmëri. Këta komponentë përfshijnë llaç e tulla, por ato janë pjesa më e lehtë. Gjithashtu përfshijnë ligjet, sistemet komplekse – duke variuar nga sistemet e informacionit të drejtimit deri tek gjithë sistemi i pagesave – dhe personeli i përgatitur. Përfundimisht, duhet të ekzistojë një “kulturë bankingu” që të reflektojë cilësi të paprekshme si profesionalizmi, integriteti dhe besimi. Disa nga këta komponentë mund të zhvillohen brenda disa vjetëve. Të tjerët mund të zgjasin një gjeneratë ose edhe më shumë për t’u ndërtuar.

Një sistem bankar, pavarësisht sa i mirëndërtuar është, nuk mund të funksionojë pa rregullin e ligjit. Transaksionet tregtare përtej nivelit këmbim mall me mall (nivelit barter) nuk do të lulëzojnë asnjëherë pa respektuar kontratat. Duhet të ekzistojnë, gjithashtu, mjete të besuara gjerësisht dhe të mbështetshme, për të zgjidhur

mosmarrëveshjet. Kritike këtu është një sistem gjyqësor që të operojë me integritet, gjykimet e të cilit të zbatohen në mënyrë rutinë.

III. Ku qëndron Shqipëria në këtë hulumtim?

Ne të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare kemi bërë një përpjekje serioze gjatë shtatë viteve të fundit për të ndihmuar në ndërtimin e infrastrukturës financiare më të fuqishme në Shqipëri, dhe për të nxitur zhvillimin institucional të sistemit financiar shqiptar. Besojmë se është arritur sukses i madh, por ende mbetet shumë punë për të bërë.

Mund të paraqitim një pamje të përafërt si vijon. Tranzicioni i Shqipërisë parashtron sfida unike për shkak të trashgimisë si një vend i izoluar gjatë kohërave komuniste. Infrastruktura e varfër fizike, përfshirë transportimin, komunikimin, mungesat në ujë dhe në energji elektrike, ka bërë që infrastruktura financiare e pazhvilluar të krijojë pengesa për biznesin dhe për zhvillimin ekonomik. Mungesa e rregullit të ligjit dhe e një sistemi gjyqësor të besueshëm janë parandalues të rritjes ekonomike, siç është korrupsioni. Nivelet e investimeve të huaja janë luhatur gjatë disa viteve të fundit, por janë përgjithësisht të ulëta në krahasim me standardet rajonale. Përqëndrimi gjeografik i eksporteve është i lartë, me dy partnerë kryesorë tregtarë, që marrin më shumë se 80 për qind të të gjitha eksporteve shqiptare. Diversifikimi i mallrave është i ulët, duke e bërë ekonominë më të prekshme ndaj goditjeve të brendshme dhe të jashtme. Në vitin 2002, Shqipëria importoi katër herë sa eksportoi.

Ekonomia joformale është e madhe. Vlerësimet e matura (konservatore) sugjerojnë se një e treta e aktivitetit të plotë ekonomik është joformale, ndërsa vlerësimet

më të larta variojnë nga 50 deri në 60 për qind të ekonomisë. Kjo ndikon negativisht në të ardhurat nga taksat dhe në qarkullimin e parasë në sistemin bankar dhe në ekonomi.

Shqiptarët që punojnë jashtë Shqipërisë ndikojnë fuqishëm ekonominë. Në vitin 2002, remitancat përbënin 13 për qind të PBB-së. Ekonomia shqiptare është mjaft e varur nga këto remitanca, të cilat përdoren kryesisht më shumë për konsum sesa për investim kapitali.

Spektori bankar i Shqipërisë është në mënyrë të diskutueshme më pak i zhvilluari në rajon. Aktualisht, nuk ekziston një “kulturë bankingu”, dhe shumë qytetarë preferojnë më mirë t’i mbajnë kursimet nën dyshek sesa në banka. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, raporti i huadhënies së sektorit privat ndaj PBB –së është vetëm 7.2 për qind, që është i njëjtë me huadhënien në Rumani, por shumë më pak sesa në vendet e tjera të afërta. Numri i bankave për frymë në Shqipëri është, gjithashtu, edhe një ndër më të ulët në rajon.

Këta faktorë janë të gjithë pengesa për t’u kapërcyer, me qëllim që Shqipëria të zhvillojë një ekonomi tregu të fuqishme. Megjithatë, Shqipëria ka bërë përparime në drejtim të zhvillimit. Qeveria ka krijuar një kuadër rregullator dhe ligjor të orientuar nga tregu. Stabilizimi makroekonomik ka qenë relativisht i suksesshëm. Shqipëria ka një ndër ritmet e rritjes më të larta në rajon, inflacioni është vënë përgjithësisht nën kontroll, pas kalimit të një periudhe të vështirë në pranverën e kaluar, dhe sektori bankar është vërtet duke u zhvilluar. Aktualisht ka katërmëdhjetë banka private, ndërkohë që kishte vetëm katër banka private operuese gjashtë vjet më parë. Banka e Shqipërisë është një institucion i fuqishëm, që i është dedikuar nxitjes së sigurisë dhe shëndetit të sektorit bankar. Dhe ka prova që tregojnë se sektori bankar mund të trajtojë një problem serioz --

periudha që kaloi Banka e Kursimeve pranverën e kaluar për shkak të ligjit të ri të sigurimit të depozitave nuk shkaktoi një krizë të përhapur bankare. Kredia për ekonominë është në rritje, ndonëse me ngadalësi, dhe niveli i huave bankare të klasifikuara si të pakthyera u pakësuan vitin e kaluar. Shqipëria ka privatizuar ose ka likuiduar afërsisht gjithë SME-të e mëparshme shtetërore, dhe po punon të privatizojë ndërmarrjet që kanë mbetur shtetërore (përfshirë Bankën e Kursimeve).

Në shumë mënyra, Shqipëria është e mirëpozicionuar të tërheqë investime të huaja direkte. Portet në Adriatik, forca punëtore e edukuar dhe e shkolluar, rrogat konkurruese dhe burimet natyrore, të gjitha janë elemente tërheqëse për investitorët. Siç është e dukshme edhe këtu në Sarandë, një vijë bregdetare e bukur mund të përbëjë, gjithashtu, një burim të ardhurash nga turizmi, por infrastruktura fizike dhe financiare duhet të zhvillohet në mënyrë që të tërheqë turistë ndërkombëtarë. Turizmi mund të shërbejë si një ndihmë e madhe për një ekonomi, dhe mjafton të shohim Italinë apo Greqinë për të parë se sa pozitiv mund të jetë ky ndikim.

Shqipëria ka shumë shanse për rritje, por edhe shumë pengesa që duhet t'i kapërcejë gjatë rrugës. Infrastruktura e tregjeve financiare të fuqishme, e përbërë prej infrastrukturës fizike, sistemeve dhe proceseve, rregullit të ligjit, një forcë pune të përgatitur dhe një kulturë bankingu, mund të ndihmojnë në nxitjen e investimeve të brendshme dhe të huaja, në promovimin e rritjes ekonomike, dhe në krijimin e kushteve të nevojshme për të inkurajuar një ekonomi tregu të lulëzuar.

IV. Çfarë përmban e ardhmja?

Rruga që po ndjek aktualisht Shqipëria, tregon padiskutim drejt zhvillimit të një ekonomie tregu. Ajo, gjithashtu, tregon drejt integritit përfundimtar në Bashkimin Evropian dhe më të gjerë në ekonominë globale. Sigurisht, ndonjëherë kjo rrugë do të jetë e vështirë, por institucionet e fuqishme mund të luajnë rol kritik për të ndihmuar Shqipërinë në përballimin e vështirësive.

Disa nga komponentët e nevojshëm të infrastrukturës janë tashmë në vend, si për shembull një bankë qendrore e angazhuar për reforma dhe një sistem bankar që po fillon të funksionojë siç duhet në një ekonomi tregu. Pjesët e tjera të infrastrukturës institucionale do të duan më shumë kohë për t'u zhvilluar. Kultura apo elementet më të paprekshme janë ndërmjet atyre që kërkojnë më shumë kohë. Për shembull, besimi i qytetarëve tek sistemi bankar mund të forcohet vetëm pasi vetë sistemi të jetë i krijuar mirë dhe të funksionojë lehtësisht. Kjo gjë mund të zgjatë me vite. Ajo kërkon dëshirë politike dhe disiplinë të madhe për ta çuar deri në fund, por përfitimet nga ky veprim do të justifikojnë përpjekjen.

Faleminderit